DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. / Br. / No. 020-117/1
-VI-
Data / Datum / Date 15-02-2019

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| **Për:** | Naim Ismaili, Kryetar i Komunës së Shtimes<br>Medina Brahaj, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Shtimes | |
| **Cc:** | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| **Përmes:** | Ivan Todosijević, Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MAPL | |
| **Nga:** | Venera Çerkini, U.D e Udhëheqësit të Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL | Datë: 12.02.2019<br>Nr.020-117 |
| **Lënda:** | Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Shtimes | |
| **Lloji i aktit:** | Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
E nderuara Kryesuese,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi Npi-01/30 për anulimin e vendimit paraprak të kuvendit Npi;01/320, dt.30.11.2018, për këmbimin e pronës së paluajtshme me sipërfaqe prej 01 hektar 02 ari 48 metra evidentuar pronë e Sali Beqa nga fshati Petrovë. |
| I miratuar më datë: 31.01.2019 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 06.02.2019 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural **<u>është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALJE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVO REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020 – 117/1
-VI-
Data Datum Date 15-02-2019

# Republika e Kosovës

## Republika Kosovo - Republic of Kosovo

**Qeveria - Vlada – Government**

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za : | Naim Ismaili, gradonačelnik Opštine Štimlje<br>Medina Brahaj, predsedavajuća Skupštine opštine Štimlje | |
| Kopija: | Jedinica za administraciju dokumentacije u MALS-u<br>Jedinica za administraciju dokumentacije u opštini<br>Zakonsko odeljenje i monitorisanje opština-MALS | |
| Preko: | Ivan Todosijević, ministar MALS-a,<br>Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka u MALS-u | |
| Od: | Venera Çerkini, v.d. rukovodioca Pravnog odeljejna i monitorisanje opština, MALS | Datum, 12.02.2019. Br.020-117 |
| Predmet: | Potvrda zakonitosti akta Skupštine opštine Štimlje | |
| Vrsta akta: | Odluka Skupštine opštine | |

Uvaženi gradonačleniče,
Uvažena predsedavajuća,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka Npi-01/30 za poništenje prelimeinarne odluke Skupštine opštine Npi;01/320, od dana,30.11.2018. godine, za razmenu nepokretne imovine opštine sa površinom od 01 hektara 02 ara 48 metara, evidentirana imovina Sali Beqa iz sela Petrovo. |
| Usvojena dana, 31.01.2019.godine, |
| Predložena za razmatranje u MALS-u, dana, 06.02.2019. godine, |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je akt opštine u proceduralnom smislu u saglasnosti sa zakonskim odrebama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak.
Ministartsvo administracije lokaklne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**KUVENDI KOMUNËS-SHTIME**
**Nr.01-060/01-2051/19 datë:21.01.2019**

**Npi – 01/30 datë 31.01.2019**

Duke u bazuar në nenin 81 dhe 82 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040, si dhe duke u bazuar në Kërkesën e Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal Nr.020-1428/3 të datës 26.12.2018, për Rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Nr.01/320 dt.30.11.2018, Kuvendi Komunës së Shtimes, në mbledhjen e mbajtur më 31.01.2019, aprovoi këtë:

HYRËS-ULAZNA-INCOMING
...Administrimit të Pushtetit Lokal
...Lokalne Samouprave i Administracije
...for Local Government Administration
Data / Datum / Date 06.02.2019

| Njësia organizative | Nr. i Lëndës | Shtojca | Vlera |
| --- | --- | --- | --- |
| 01 | 020-117 | | |

## V E N D I M

**Për Anulimin e vendimit paraprak të Kuvendit, Npi: 01/320, dt.30.11.2018 për këmbimin e pronës së paluajtshme me sipërfaqe prej 01hektar 02ari 48metra, evidentuar pronë e Sali Beqa nga fshati Petrovë**

I

**Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -I- të rregullt për vitin 2019, të mbajtur më 31.01.2019, unanimisht vendosi që ta shtyej zgjidhjen e kësaj çështjeje deri sa Ekzekutivi i Komunës t'i propozojë Kuvendit një zgjidhje të qëndrueshme të bazuar në miratimin e Hartave Zonale dhe të Planit Zhvillimor Komunal, për arsye të shmangies të rrethanave tensionuese, që janë krijuar në mes të Sali Beqajt, pronarit të tokës me sipërfaqe prej 01.02.48, në Ngastrat Kadastrale: P-313-3; P-313-4; P-313-5 dhe P-313-6, Z.K.-Davidovc, dhe Komunitetit të fshatit Davidovc, të cilët kërkojnë që kjo sipërfaqe të shfrytëzohet për nevoja të fshatit, Kuvendi i Komunës së Shtimes, anuloi Vendimin paraprak, Npi:01/320, datë: 30.11.2018, për këmbimin e pronës së paluajtshme, sipas Kërkesës Nr.020-1428/3 të datës 26.12.2018, të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, për rishqyrtimin e Ligjshmërisë të aktit të Kuvendit të Komunës së Shtimes.**

II

Vendimi është aprovuar duke marrë për bazë edhe rekomandimet e Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi dhe të Komitetit për Politikë e Financa.

III

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe publikimi në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.

REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – KOMUNA E SHTIMES – OPŠTINA ŠTIMLJE

Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj

DALJE-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-1428/3
Data Datum Date 26.12.2018

# Republika e Kosovës

## Republika Kosovo - Republic of Kosovo

**Qeveria - Vlada - Government**

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

---

| | | |
|---|---|---|
| Për : | Naim Ismaili, Kryetar i Komunës së Shtimes<br>Medina Brahaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes | |
| Kopje: | Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë<br>Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave - MAPL | |
| Përmes: | Ivan Todosijević, Minister i MAPL-së,<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | Venera Çerkini a, U.D. e Udhëheqësit të Departamentit Ligjor dhe Monitorimit të Komunave, MAPL | Datë:<br>18/12/2018 |
| Lënda: | Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë e aktit të komunës së Shtimes | 020-1428 |
| Lloji i aktit: | Vendim i kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi Npi-01/320 për këmbimin e pronës së paluajtshme me sipërfaqe prej; (01.02.48) evidentuar pronë e Sali Beqa - Petrovë. |
| I miratuar më datë: 30.11.2018 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07.12.2018 |

Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

| Nr. | Formulimi në aktin e komunës | Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim. |
|---|---|---|
| 1. | Vendimi Npi-01/320 për këmbimin e pronës së paluajtshme me sipërfaqe prej; (01.02.48) evidentuar pronë e Sali Beqa - Petrovë. | Vendimi Npi-01/320 për këmbimin e pronës së paluajtshme me sipërfaqe prej; (01.02.48) evidentuar pronë e Sali Beqa – Petrovë i miratuar nga kuvendi i komunës së Shtimes është në kundërshtim më nenin 11 të Ligjit Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, përkatësisht pikën 11.2 dhe 11.3 të këtij ligji ku sqarohet se Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës pronën e paluajtshme komunale për këmbim me persona fizik dhe juridik si dhe nëse nevoja për tokën e tillë arsyetohet në planet zhvillimore komunale si dhe financimi kapital për ndërtimin e atij objekti për shfrytëzim publik është i siguruar.<br><br>Bazuar në këtë kuvendi i komunës së Shtimes duhet të rishqyrtoj këtë vendim dhe të harmonizoj me legjislacionin në fuqi, andaj ky vendim si i tillë nuk krijon efekt juridik dhe nuk mund të zbatohet. |

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal *kërkon* nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Shtimes, që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALAZJA-IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-1428/3
Data Datum Date 26.12.2018

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| **Za:** | Naim Ismaili, gradonačelnik opštine Štimlje<br>Medina Brahaj, predsedavajuća Skupštine opštine Štimlje | |
| **Kopija:** | Jedinica za upravljanje dokumentima u MALS<br>Jedinica za upravljanje dokumentima u opštini<br>Pravno odeljenje i monitorisanje opština, MALS | |
| **Preko:** | Ivan Todosijević, ministar MALS-a,<br>Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a | |
| **Od:** | Venera Çerkini, v.d. rukovodioca pravnog odeljenja i monitorisanje opština, MALS | Dana:<br>18.12.2018.<br>020-1428 |
| **Predmet:** | Zahtev za ponovno razmatranje zakonitosti akta opštine Štimlje | |
| **Vrsta akta:** | Odluka Skupštine opštine | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovana predsedavajuća,

U skladu sa Uredbom Vlade Republike Kosova br.01/2016 za administrativno razmatranje opštinskih akata, i na osnovu zakonskih nadležnosti ministarstva, određenim osnovnim zakonima i Vladinom Uredbom br.02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta premijera i ministarstva, odeljenju za pravna pitanja i monitorisanje opština Ministarstva administracije lokalne samouprave je dostavljen sledeći opštinski akt za obavezno razmatranje zakonitosti, onako kako se predviđa članom 81 Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi:

| |
|---|
| Odluka Npi-01/320 za razmenu nepokretne imovine u površini od: (01.02.48) utvrđena kao vlasništvo Sali Beqa – Petrovo. |
| Usvojena dana: 30.11.2018. godine |
| Dostavljena MALS-u za razmatranje dana: 07.12.2018. godine. |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog opštinskog akta, ceni da je opštinski akt **u suprotnosti sa odredbama zakonodavstva na snazi.**

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

| Br. | Formuliranje u opštinskom aktu | Zakonska odredba sa kojom je opštinski akt u suprotnosti. |
|---|---|---|
| 1. | Odluka Npi-01/320 za razmenu nepokretne imovine u površini od: (01.02.48) utvrđena kao vlasništvo Sali Beqa - Petrovo. | Odluka Npi-01/320 za razmenu nepokretne imovine u površini od: (01.02.48) utvrđena kao vlasništvo Sali Beqa - Petrovo, usvojena od Skupštine opštine Štimlje je u suprotnosti sa članom 11 Zakona br.04/L-144 o davanju na korišćenje i razmenu opštinske nepokretne imovine, odnosno tačka 11.2 i 11.3 ovog zakona gde se navodi da gradonačelnik predlaže Skupštini opštine nepokretnu imovinu opštine za razmenu sa fizičkim i pravnim licima i ako je potreba za takvo zemljište opravdana u opštinskim razvojnim planovima i da li su obezbeđena kapitalna finansiranja za izgradnju tog objekta za javnu upotrebu.<br><br>Na osnovu ovog, Skupština opštine Štimlje treba izvršiti ponovno razmatranje ove odluke i uskladi sa važećim zakonima, prema tome ova odluka ne stvara pravni efekat i ne može da se sprovodi. |

Na osnovu gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouprave ***traži*** od Skupštine opštine/gradonačelnika opštine Štimlje, da preduzmu konkretne mere kako bi se opštinski akt uskladio sa zakonskim odredbama na snazi, u roku od 30 dana od dana dostavljanja zahteva za ponovno razmatranje akta.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za bilo kakvo objašnjenje u vezi sa ovom procenom.

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME**
**Nr.01-060/01-33039/18 datë:20.11.2018**

Npi – 01/320 Date: 30.11.2018

Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën Nr.01-070/05-28636/18 datë. 25.09.2018, të z.Selman Fazlija nga fshati Davidovc, i cili në emër të Kryetarit të Fshatit Davidovc z.Elmi Sadriu, ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës së Shtimes, që ta kthejë në interes të fshatit, pjesën e tokës të tjetërsuar pa pëlqimin e Komunitetit të fshatit, te personi fizik z.Sali Beqa nga fshati Petrovë. Më datën 08.05.2006 kemi bërë kërkesën Nr.1-7-5029 ku kemi kërkuar që këto parcela të destinohen për zgjerimin e Varrezave të fshatit dhe ti bashkëngjiten varrezave të tanishme e që asnjëherë ne nuk kemi marrë përgjigje. Po ashtu më datën 01.02.2017 kemi bërë kërkesë Nr.01-70/01-2219/17, ku kemi kërkuar që parcelat e njëjta të destinohen për nevojat e komunitetit të fshatit, e që nuk është marrë vendim meritor. Kërkesën tani e mbështesim edhe në Peticionin e 308 banorëve të fshatit të vërtetuar me nënshkrimet e tyre më 26.07.2006, si dhe Peticioni tjetër i organizuar më 21.09.2018 me 69 nënshkrime të banorëve. Duke marrë parasysh rrethanat tensionuese që janë krijuar me provokimet e pronarit jo legjitim Sali Beqa, kërkojmë nga Kuvendi që të marrë vendim në të mirë të komunitetit të fshatit Davidovc.

Kuvendi i Komunës, duke u bazuar në nenin 12.2 pika (d) të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosoves" Nr. 28/2008), dhe pas propozimeve të dhëna nga Nënkryetari dhe Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi, se nuk e lejon ligji mundësinë e këmbimit të pronës, po ashtu duke marrë për bazë edhe Rekomandimet e Komiteti për Politikë e Financa, në mbledhjen e mbajtur më 30.11.2018, Aprovoi këtë:

**VENDIM**

**PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME ME SIPËRFAQE PREJ: (01.02.48) EVIDENTUAR PRONË E SALI BEQA - PETROVË**

**I**

**Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -XI- të rregullt për vitin 2018, të mbajtur më datën:30.11.2018, me shumicën e votave mori vendim që për pronën e paluajtshme të z.Sali /Fehmi/ Beqa nga fshati Petrovë, me sipërfaqe prej: 01.02.48 (Një hektar, dy ari e katërdhjetë e tetë metra) me numër të Ngastrave Kadastrale: P-313-3; P-313-4; P-313-5 dhe P-313-6, Z.K.-Davidovc, të fillohet procedurara nga ekzekutivi për këmbimin e kësaj prone me ndonjë pronë tjetër Komunale, e jo të shpronësohet me mjete financiare.**

**II**

A r s y e t i m: Kërkesa Nr.01-070/05-28636/18 e komunitetit të fshatit Davidovc aprovohet, sikurse në dispozitiv për arsye të shmangies të rrethanave tensionuese, që janë krijuar në mes pronarit z.Sali Beqa dhe Komunitetit të fshatit Davidovc, të cilët kërkojnë që kjo sipërfaqe të shfrytëzohet për nevoja të fshatit. z.Sali Beqa, pronarë i kësaj prone është bërë në bazë të Aktvendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Nr.01/06/7425/3/3 të datës: 25.09.2007, ku toka në fshatin Davidovc i është dhënë si kompenzim ari për ari me tokën në fshatin Lagja e Pajtimit (Petroviq) për ndërtimin e Shkollës, në Ngastrën Kadastrale Nr.196-0, Z.K-Petroviq me sipërfaqe (01.02.54). Komuna e Shtimes nuk ka ende projekt për funksionalizimin e kësaj hapësire, në fshatin Davidovc, por gjatë hartimit të Hartave Zonale dhe Planin Zhvillimor Komunal do të propozojmë që parcelat Nr.313-6 dhe Nr.313-4 me sipërfaqe prej 19 ari të destinohen për Park, Çerdhe apo Shkollë, parcela Nr.313-5 me nje sipërfaqe prej 10 ari do të destinohet për varreza te fshatit dhe parcela me Nr.313-3 me një sipërfaqe prej 73.48 ari do të destinohet si zonë afariste-biznesore.

**III**

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushteti Lokal dhe Zyrës për Informim.

Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahui

15

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR /MINISTARSTVO SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA/MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANNING
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# EKSTRAKT NGA CERTIFIKATA/IZVOD IZ CERTIFIKATA/EXTRACT OF CERTIFICATE

## PERSONI / OSOBA /PERSON : BEQAJ SALI

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 2177/18 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 11.12.2018 - 08:13 |
| Komuna / Opština / Municipality: | Shtime / Štimlje / Shtime |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | Shtime / Štimlje / Shtime |

## A. TË DHËNAT PËR PERSONIN / PODACI O OSOBI / PERSON'S DATA

| Mbiemri/Emri i afarizmit (biznesit) Prezime/ Naziv poslovanja (biznisa) Last Name / Business Name | Emri Ime First Name | Emri i babait Ime oca Father's Name | Gjinia Pol Gender | Nr. personal/ biznesit Lični broj/broj poslovanja ID. No. | Shteti i shtetësisë apo regjistrimit Država državljanstva ili ukojiženja Country ofcitizenship | Ditëlindja/Data e themelimit Rođendan/Dan osnivanja Date of Birth/Establishment | Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| BEQAJ | SALI | FEHMI | Mashkull / Musko / Male | 1014104557 | KOSOVA / KOSOVA / KOSOVO | 05.05.1963 | | 11.03.2016 |

## A.1 ADRESA E PERSONIT / ADRESA OSOBE / PERSON'S ADDRESS

| Vendbanimi Prebivaliste Resident | Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code | Hollësitë e adresës Pojedinosti adrese Address Details | Adresa tjetër Druga adresa Other address | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|
| PETROVË / PETROVO / PETROVË | | | PETROVË | 11.03.2016 |

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E SHTIMES-OPSTINA SHTIME-ŠTIMLJE

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Kadrije.Zeqa | Personi/Osoba/Person: BEQAJ SALI

Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

## B. NJESIA KADASTRALE/ KATASTARSKA JEDINICA/CADASTRAL UNIT

| Njësia kadastrale Katastarska jedinica Cadastral unit | Komuna / Opština / Municipality | Zona kadastrale Katastarska zona Cadastral zone | Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit type | Tipi i pronës Tip imovine Property Type / Lloji i pronës Vrsta imovine Property kind | Kati/ Katet Br.Sprat a/ Spratova Floor number | Vendi i quajtur Zvano mesto Place name | Sipërfaqja Površina Area | Shfrytëzimi aktual/Kultura-klasa Aktuelna upotreba/ Kultura-klasa Actual use/Culture-class | Pjesa e pronës Deo imovine Share quota | Lloji i së drejtës Vrsta prava Type of the right | Azhuruar Ažurirano Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-72809023-00313-3 | Shtime / Štimlje / Shtime | DAVIDOC / DAVIDOVCE / DAVIDOVC | PARCELË / PARCELA / parcel | Pronë private Privatna Imovina Privatelly owned Land / R | | UTRINË / UTRINË / UTRINË | 7348 | Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 1 / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 1 Klase / / Agriculture - pasture - 1st Class Pasture / / | 1 / 1 | Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | 26.10.2018 |
| P-72809023-00313-4 | Shtime / Štimlje / Shtime | DAVIDOC / DAVIDOVCE / DAVIDOVC | PARCELË / PARCELA / parcel | Pronë private Privatna Imovina Privatelly owned Land / R | | UTRINË / UTRINË / UTRINË | 1000 | Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 1 / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 1 Klase / / Agriculture - pasture - 1st Class Pasture / / | 1 / 1 | Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | 26.10.2018 |
| P-72809023-00313-5 | Shtime / Štimlje / Shtime | DAVIDOC / DAVIDOVCE / DAVIDOVC | PARCELË / PARCELA / parcel | Pronë private Privatna Imovina Privatelly owned Land / R | | UTRINË / UTRINË / UTRINË | 1000 | Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 1 / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 1 Klase / / Agriculture - pasture - 1st Class Pasture / / | 1 / 1 | Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | 26.10.2018 |
| P-72809023-00313-6 | Shtime / Štimlje / Shtime | DAVIDOC / DAVIDOVCE / DAVIDOVC | PARCELË / PARCELA / parcel | Pronë private Privatna Imovina Privatelly owned Land / R | | UTRINË / UTRINË / UTRINË | 900 | Bujqësore - Kullosat - Kullosë E Klasës 1 / / Poljoprivredno - Pašnjaci - Pasnjak 1 Klase / / Agriculture - pasture - 1st Class Pasture / / | 1 / 1 | Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | 26.10.2018 |

Printuar nga / Odštampani od / Printed by: Kadrije.Zeqa | Personi/Osoba/Person: BEQAJ SALI |

**Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person**